



Funded by  
the European Union

# RAPORT ANALITIK

Impakti i mirëqenies psikologjike të  
nxënësve në rezultatet mësimore



EduPod 4



**KEC**  
Qendra për Arsime Kosovës  
Kosova Education Center

Projekti *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - shkurt **IDEA 2022**, financohet nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe vihet në zbatim nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Me qëllim të përmirësimit të cilësisë së arsimit, projekti synon të identifikojë problematikat e fushës së arsimit në Kosovë duke zgjeruar hapësirat për debat publik me anë të shfrytëzimit të teknologjive inovative siç janë podcastet. Në këto diskutime janë të përfshira palë kyçe në sistemin arsimor, si nxënës/e, mësuesdhënës/e, prindër, politikëbërës etj. ku u jepet mundësia për të ballafaquar mendimet dhe pikëpamjet e tyre.

Seria e podcasteve **EduPod** (shkurtesë e *Education Podcast*) është e llojit të vet në Kosovë, si podcasti i parë me karakter edukativo-arsimor i cili trajton çështjet e arsimit në këtë formë. Synohet që me anë të EduPod të shtrihet sa më gjerë debati rreth arsimit dhe të zgjerohen hapësirat për të dëgjuar dhe përfshirë mendimet e të gjitha palëve në arsim, me fokus të veçantë tek nxënësit/et. Këto raporte analitike janë përmbledhje e diskutimeve dhe rekomandimeve të dala nga podcastet e realizuara.

Design: **envinion**

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e programit një-vjeçar *Zhvillim Inovativ për Avancimin e Arsimit* - **IDEA 2022**, i financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, në kuadër të Marrëveshjes Kornizë për Partneritet (Framework Partnership Agreement) të nënshkruar ndërmjet KEC dhe Zyrës së BE-së në Kosovë në nëntor të vitit 2019. Përmbajtja e këtij publikimi nuk do të konsiderohet në asnjë mënyrë si pasqyrim i qëndrimeve të Bashkimit Evropian.



# RAPORT ANALITIK

Impakti i mirëqenies  
psikologjike të nxënësve në  
rezultatet mësimore

# Hyrje

Podkasti i parë me karakter specifik edukativo-arsimor në Kosovë, i quajtur “EduPod”, filloi realizimin e tij më 23 mars 2022 në kuadër të projektit Zhvillimi Inovativ për Avancimin e Arsimit / Innovating Development for Education Advancement – IDEA 2022, i cili financohet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës, KEC. Projekti IDEA 2022 synon përmirësimin e cilësisë së arsimit përmes identifikimit dhe trajtimit të çështjeve të arsimit në Kosovë me anë të debateve publike me bazë të gjerë.

Podkasti “Impakti i mirëqenies psikologjike të nxënësve në rezultatet mësimore” është i katërti prej një serie podkastesh të planifikuara gjatë këtij viti programor. Ky podkast është vazhdimësi e temave paraprake të cilat në fokus kishin përvojat arsimore gjatë kohës së pandemisë, pabarazitë në arsim dhe pritshmëritë e nxënësve për arsim cilësor, dhe pothuajse në të gjitha podkastet paraprake mbizotëronte diskutimi mbi gjendjen emocionale dhe mirëqenien mendore të nxënësve. Qëllimi i këtij podkasti ishte të analizojë aspektin psikologjik të nxënësve të nivelit parauniversitar në vazhden e procesit mësimor dhe në ambientin shkollor, si dhe ndikimin e tij tek rezultatet mësimore të nxënësve.

Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh) në bashkëpunim me UNESCO-n dhe UNICEF-in në vitin 1995 inicuan idenë “Shkollat si promovuese të shëndetit”, nismë kjo e cila parasheh shëndetin mendor dhe promovimin e mirëqenies ndër aspektet kryesore të shkollave (WHO, n.d.). Sipas Orhan Z., në këndvështrimin tonë duhet të theksojmë faktin se shkathtësitë emocionale janë baza për të gjitha llojet e mësimave dhe shkathtësive të tjera, prandaj thuhet se suksesi në mësim nuk varet vetëm nga sasia e dijeve që arrin të fitoj nxënësi gjatë viteve të shkollimit, por edhe nga përvetësimi i shumë aftësive të tjera të sjelljes sociale në përgjithësi. Poashtu, vëzhgime të shumta tregojnë se nxënësit e dobët në mësim shfaqin mangësi të tilla si: mungesa e kureshtjes dhe vetëbesimit, të qenit i padurueshëm dhe i pa vëmendshëm për të dëgjuar udhëzimet dhe për të kërkuar ndihmë nga mësuesit apo edukatorët e tyre, nuk janë në gjendje të kontrollojnë shumë gjendje emocionale apo sjellje josociale, dhe nuk mund t’i shprehin dëshirat e tyre gjatë kohës së shoqërimit me fëmijë të tjerë.

Për më tepër, mësimdhënia dhe mësimnxënia në shkolla kanë komponentë të fuqishme shoqërore, emocionale dhe akademike (Zins, 2004). Nxënësit zakonisht nuk mësojnë vetëm, por në bashkëpunim me mësuesit e tyre, me shoqërinë e bashkëmoshatarëve të tyre dhe me nxitjen e familjeve të tyre. Gjendjet e ndryshme emocionale mund të lehtësojnë ose pengojnë angazhimin akademik të fëmijëve, etikën e punës, angazhimin dhe suksesin përfundimtar të shkollës. Për shkak se marrëdhëniet dhe proceset emocionale ndikojnë se si dhe çfarë mësojmë, shkollat dhe familjet duhet të trajtojnë në mënyrë efektive këto aspekte të procesit arsimor për të mirën e të gjithë nxënësve (Elias, 1997).

Besohet gjithashtu se mirëqenia e fëmijëve dhe adoleshentëve, si dhe promovimi dhe përmirësimi i aftësive personale dhe sociale, nuk mund të ndodhin vetvetiu, por kërkohet që i gjithë sistemi i tërë i punës edukative

në shkolla, familje apo organizata e grupe shoqërore të planifikojnë dhe organizojnë një sërë aktivitete dhe programesh që mbështesin dhe përkrahin transformimin, veçanërisht të shkollës dhe mjedisit shkollor, në një mjedis që mbështet dhe promovon mirëqenien e përgjithshme psikologjike, e cila përkufizohet si një gjendje në të cilën individi është i aftë të kuptojë aftësitë e veta, mund të ballafaqojë situatat stresuese normale jetësore, dhe është i aftë të punojë në mënyrë produktive dhe të japë kontributin e saj/tij në komunitet (DSM-5, 2013). ((2013))

Sipas studimeve të ndryshme, programet e promovimit të shëndetit mendor në shkolla luajnë një rol të rëndësishëm për një shëndet të mirë mendor, social si dhe në rezultatet e të nxënësve. Për më shumë, autorët Baskaran, Sekar dhe Kokilavani (2016) theksojnë se kur shqetësimet dhe problemet e nxënësve janë trajtuar siç duhet, gjasat e suksesit në shkollë janë rritur, kështu duke pohuar se promovimi i shëndetit mendor në shkolla është i lidhur me arritje dhe kompetenca më të mëdha akademike; zvogëlim në incidencën e sjelljeve problematike; përmirësim në marrëdhëniet që rrethojnë çdo fëmijë, ndryshime thelbësore pozitive në shkollë dhe atmosferën në klasë. Shkollat, në praktikë kanë ndikim tek të gjithë, duke përfshirë nxënësit, pedagogët dhe personelin, dhe përpos rezultateve akademike ato mund të kontribuojnë në zhvillimin personal, komunitar dhe kombëtar.

Publikimi i OBSH-së “Të bëjmë çdo shkollë një shkollë për promovimin e shëndetit - Standardet dhe treguesit globalë” ofron burime të vlefshme për sistemet arsimore që kërkojnë të promovojnë dhe përmirësojnë shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve përmes qeverisjes së përmirësuar. Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, asnjë sistem arsimor nuk mund të jetë efektiv nëse nuk promovon shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, mësuesve dhe komunitetit të tij (WHO, n.d.). Në këtë publikim, bazuar në një numër të madh provash, tetë standarde globale janë propozuar, së bashku me udhëzime të detajuara në 13 fusha zbatimi, si dhe strategji shoqëruese dhe një proces që do të lejojë përshtatjen specifike të vendit. Për më tepër, rastet studimore tregojnë se si promovimi i shëndetit në shkolla zbatohet si në vendet me të ardhura të larta ashtu edhe në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme. (WHO, n.d.). Zbatimi i këtyre standardeve globale mund të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e 1.9 miliardë fëmijëve të moshës shkollore, adoleshentëve dhe mësuesve në mbarë botën, duke sjellë një dividend të trefishtë për studentët sot, të rriturit nesër dhe brezat e ardhshëm të fëmijëve.

Duke parë rëndësinë e këtij aspekti, Edupod 4 shtjelloi temën “Impakti i mirëqenies psikologjike të nxënësve në rezultatet mësimore”. Të ftuarit në këtë diskutim ishin njohës të sektorit të arsimit dhe ekspertë të fushës së psikologjisë dhe aspekteve të ndërlidhura. Pjesëmarrësit diskutuan kryesisht situatën aktuale me psikologët në shkollat e Kosovës, duke shkëmbyer përvojat personale, duke i referuar burimeve dhe statistikave ekzistuese që nxjerrin në pah shkaqet dhe arsyet e gjendjes aktuale, problemet që dalin dhe sfidat që hasen, si dhe ofruan rekomandime për zgjidhje konkrete.



### **Pjesëmarrëset në diskutim ishin:**

**Valdet Plakolli**, Psikolog shkollor, dhe

**Arian Musliu**, Asistent në Fakultetin e Edukimit.

Përmbajtja e diskutimit në EduPod 4 është hartuar në bashkëpunim të ngushtë mes ekspertes së angazhuar si konsulente për të realizuar këtë podkast dhe menaxherit së projektit IDEA 2022. Fillimisht është përgatitur përmbajtja bazuar në temën e përcaktuar, për tu zbërthyer në pyetjet të cilat janë adresuar për mysafirët, të cilët paraprakisht janë takuar dhe kanë diskutuar përmbajtjen e përgatitur, duke dhënë kontributin e tyre në përpilimin e pyetjeve sa më të qarta dhe koncize, në mënyrë që diskutimi të zhvillohet natyrshëm duke përshtetur gjendjen aktuale, me theks të veçantë mirëqenien e nxënësve dhe ndikimin në performancën shkollore.



**EduPod 4**

është shfaqur livestream në faqen e Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në Facebook, dhe deri më 3 nëntor 2022 ka arritur



**1145**  
shikime



ku shumë prej tyre kanë reaguar dhe/ose komentuar dhe e kanë përcjellë ose shpërndarë më tej postimin.

**Regjistrimi i podkastit në version audio dhe video është publikuar në kanalin e KEC-it në YouTube, dhe regjistrimi në version audio (mp3) është dërguar për transmetim në Radio Kosova.**



Po ashtu, versioni audio i këtij podkasti është vendosur edhe në platformën elektronike të portalit Nacionalë. EduPod 4 mund të ndiqet në çdo kohë duke klikuar në vegzat e mëposhtme:



Faqja e KEC-it në Facebook:

<https://www.facebook.com/QendraperArsimeKosoves/videos/806305027245117>



Kanali zyrtar i KEC-it në YouTube:

<https://www.youtube.com/watch?v=4kPvtmjCgyg>



Në portalin Nacionalë:

\*\*\*

Rezultatet e identifikuar nga ky podkast i realizuar, do të analizohen dhe trajtohen nga rrjeti informal i OSHC-ve të arsimit parauniversitar, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve të përbashkëta nga përfaqësuesit e rrjetit dhe inicimit të nismave avokuese në fushën e arsimit.

# Diskutimet

**Saranda Rexha** në cilësinë e moderatores së diskutimit në fjalën e saj hyrëse prezantoi panelistët dhe theksoi përvojën dhe ekspertizën e tyre të konsiderueshme në temën që do të diskutohet. Për të filluar diskutimin, **Saranda Rexha** vëri në pah përkufizimin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për shëndetin mendor, ku theksohet se shëndeti mendor përkufizohet si një gjendje e mirëqenies në të cilën çdo individ zhvillon potencialin e tij ose të saj, përballon streset e jetës së përditshme, punon në mënyrë produktive dhe frytdhënëse dhe është në gjendje të kontribuojë në komunitetin e tij/saj. **Saranda Rexha** gjithashtu ceku se shëndeti mendor poashtu është një komponent i rëndësishëm i shëndetit dhe mirëqenies së përgjithshme sepse na ndihmon të marrim vendime, të ndërtojmë marrëdhënie dhe të formojmë botën ku jetojmë. Për më tepër është një e drejtë themelore e njeriut, dhe është thelbësore për zhvillimin personal, komunitar dhe socio-ekonomik. Poashtu në hyrje të diskutimit, u citua se promovimi i shëndetit mendor të fëmijëve dhe adoleshentëve është një tjetër prioritet dhe mund të arrihet me politika dhe ligje që promovojnë dhe mbrojnë shëndetin mendor, duke zbatuar programe të bazuara në shkollë dhe duke përmirësuar cilësinë e komunitetit. Programet e të mësuarit social dhe emocional në shkollë janë ndër strategjitë më efektive të promovimit të mirëqenies mendore të fëmijëve/nxënësve.

Duke pohuar përkufizimin e lartpërmendur, **z. Valdet Plakolli** theksoi se shëndeti i mirë mendor është më kompleks dhe më i përgjithshëm, me ndikim në shumë fusha të zhvillimit të fëmijës, në këtë rast të nxënësve. Poashtu, **Valdet Plakolli** deklaroi se sipas statistikave globale rreth 10% e fëmijëve potencialisht mund të kenë shqetësime të ndryshme psikologjike, ku sipas tij këto të dhëna janë relevante edhe tek shoqëria jonë. **Valdeti** gjithashtu ndau përvojën e tij personale si psikolog shkollor, nga momenti kur krijohen kontaktet e para të fëmijës me ambientet shkollore dhe raportet fillestare me mësimitdhënës, duke theksuar se ndërsa fëmijët janë përgjithësisht të shëndetshëm dhe të socializuar, duhet mbajtur mend gjithmonë se ata sjellin me vete një konstrukt familjar që shfaqet vazhdimisht në shkollë. **Valdeti** tregoi gjithashtu se roli i psikologut shkollor fokusohet më shumë në identifikimin dhe këshillimin për të ndihmuar fëmijët/nxënësit të kapërcejnë vështirësitë, të përmirësojnë sjelljen dhe marrëdhëniet me të tjerët, të përballojnë situata të ngarkuara emocionalisht që ndikojnë në performancën e tyre në shkollë, në aspektin social, të sjelljes dhe emocional. Psikologët e shkollës duhet të punojnë ngushtë me familjet, mësuesit, personelin e shkollës dhe profesionistë të tjerë për të krijuar mjedise mësimi të sigurta, të shëndetshme dhe mbështetëse që forcojnë lidhjet midis familjes, shkollës dhe komunitetit.

Sipas folësit **z. Arian Musliut**, pjesëmarrja në këtë podkast të organizuar nga KEC, respektivisht diskutimi për temën, ndihmon që të bëhet një lloj psikoedukimi, duke treguar se deri vonë shëndetit mendor nuk i është kushtuar rëndësia e duhur në krahasim me shëndetin fizik dhe se mirëqenia e një individi është një tërësi e të dy sistemeve dhe nuk mund të flasim për to si të ndara. Sipas Arianit, roli i prindërve në identifikimin dhe trajtimin e shqetësimeve, për të siguruar që fëmijët të kenë mbështetjen e duhur sociale dhe emocionale është jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe kontribuon në shëndetin mendor të fëmijëve/nxënësve, por ka një stigmë kur diskutohen problemet e nxënësve, dhe një nevojë e konsiderueshme për ndërgjegjësim dhe informim të

drejtë, si dhe rritje të pjesëmarrjes në aktivitetet ndërgjegjësuere. Megjithatë, me një vlerësim pozitiv, u diskutua se, krahasuar me periudhat e mëparshme, ka një përmirësim të qartë dhe se prindërit janë të gatshëm për bashkëpunim. Përsa i përket rolit të shkollës në mirëqenien psikologjike të nxënësve, pavarësisht se shkolla vlerësohet si institucioni më i përshtatshëm për fëmijët dhe që duhet të shërbejë si një platformë efektive për ofrimin e programeve universale për të gjithë nxënësit, kjo konsiderohet si një sfidë që kërkon angazhimin e të gjithëve për ta realizuar. Shkollat tona janë dukshëm më të mira se në të kaluarën, por ka ende vend për përmirësim dhe rritje të nivelit të ndërgjegjësimit. Folësit gjithashtu theksuan mungesën e psikologëve në shkolla, ekipet multidisiplinare dhe hapësirat e përshtatshme ku nxënësit mund të diskutojnë dhe flasin lirshëm, qoftë për marrëdhëniet me bashkëmoshatarët apo mësuesit.

Sipas Arianit, njëra prej aspekteve kyçe është përfshirja e ekipeve multidisiplinare brenda shkollave, përfshirë ristrukturimin e mënyrës së punës, në mënyrë që të adresohen edhe përcaktuesit social të shëndetit, duke zhvilluar normat dhe aftësitë socio-emocionale të bashkëmoshatarëve, nëpërmjet fuqizimit të tyre në shmangien e sjelljeve të dëmshme dhe abuzive, si dhe nëpërmjet nismave të bazuara në të drejtat e fëmijëve dhe edukimit gjithëpërfshirës. Përfshirja e ekipeve të tilla do të mundësonte të fokusohemi në mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve/nxënësve e jo vetëm në performancën akademike, e që edhe kjo e fundit ka nevojë për përmirësim. Diskutimi u thellua edhe më shumë në atë se si shkollat do të duhej të ishin për nxënësit, duke përfshirë këtu infrastrukturën, inventarin, mësimdhënësit, atmosferën miqësore dhe klimën e bashkëpunimit, duke ofruar njëkohësisht ambiente të sigurta e të qasshme për të gjithë, ku fëmijët do të ndiheshin më mirë se në shtëpitë e tyre.

Sipas **Arian Musliut**, një nga aspektet më të rëndësishme është përfshirja e ekipeve multidisiplinare brenda shkollave, përfshirë ristrukturimin e mënyrës së punës, në mënyrë që të adresohen edhe përcaktuesit social të shëndetit, duke zhvilluar normat dhe aftësitë socio-emocionale të bashkëmoshatarëve, nëpërmjet fuqizimit të tyre në shmangien e sjelljeve të dëmshme dhe abuzive, si dhe nëpërmjet nismave të bazuara në të drejtat e fëmijëve dhe edukimit gjithëpërfshirës. Përfshirja e ekipeve të tilla do të na lejonte të fokusohemi në mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve/nxënësve dhe jo vetëm në performancën akademike, e cila gjithashtu duhet të përmirësohet. Më pas diskutimi kaloi në atë se si duhet të jenë shkollat për nxënësit, duke përfshirë infrastrukturën, inventarin, mësuesit, një atmosferë miqësore dhe një klimë bashkëpunimi, duke ofruar gjithashtu mjedise të sigurta dhe të qasshme për të gjithë fëmijët.

Duke vazhduar diskutimin për rolin e mësuesve dhe duke krahasuar sistemin e trajnimit të mësuesve në të kaluarën me reformat që kanë ndodhur në Fakultetin e Edukimit, **Ariani** pohon se mësuesit kanë shumë më tepër lëndë psikologjike në kurset e tyre përgatitore dhe janë gjithashtu të përgatitur të identifikojnë probleme ose sjellje atipike që mund t'i referohen një psikologu. Sipas folësve, roli i mësuesve në identifikim është kyç dhe lehtëson punën e psikologut, përndryshe është shumë sfiduese për psikologët e shkollave të trajtojnë të gjitha problematikat dhe problemet e nxënësve, ku dihet se janë rreth 200 psikologë, ndërkohë që janë mbi 1300 shkolla në vendin tonë. Ndër sfidat tjera të punës së psikologut shkollor, që mund të cilësohet si më e ndjeshmja, është çështja e referimit, pasi nuk ka një sistem të qartë, madje edhe në rastet kur bëhet referimi, një nga mënyrat është ajo në Psikiatrinë e Fëmijëve në QKUK, por kjo ngërthen një problem tjetër, që është kohëzgjatja e marrjes së shërbimit. Megjithatë, disa çështje janë të rregulluara dhe në disa komuna, ekipet ko-



munale multidisiplinare për identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta janë funksionale dhe bashkëpunojnë mirë me shkollat, por kjo është vetëm për një grup të caktuar dhe nuk është e disponueshme për të gjithë.

**Valdeti** gjithashtu përmendi përvojën e tij gjatë vizitës studimore në Slloveni, ku çdo shkollë fillore dhe e mesme ka një zyrë këshillimi shkollor me një profesionist të shëndetit mendor (psikolog, punonjës social, ose pedagog (social). Ata fokusohen në çështjet e të mësuarit dhe shërbimet parandaluese në mjedisin shkollor, si dhe këshillimin dhe referimin për fëmijët, adoleshentët dhe prindërit. Si rezultat i diskutimit, u theksua që brenda shkollave duhet të krijohen ekupe multidisiplinare, edhe pse kjo mund të marrë pak kohë. Një rekomandim tjetër që duhet të adresohet menjëherë është ndryshimi i udhëzimeve administrative për psikologët në shkolla si dhe ofrimi i hapësirës për profesionistët për të kontribuar, duke ofruar pako të instrumenteve dhjetrajnime të ndryshme në mënyrë që të mund të arrijmë atë që të gjithë e dëshirojnë e që është mirëqenia e fëmijëve.

# Përfundime

Pjesëmarrësit në Edupod 4 zhvilluan një bisedë mjaft përmbajtësore, dhe me optimizëm u deklaruan se deri në realizimin e asaj që të gjithë dëshirojnë të shohim në shkolla kërkohet konsistencë e lartë dhe angazhim i madh i të gjithëve, dhe rekomandimet nga ky diskutim do të na orientojnë në zgjerim të diskutimit në takimet apo aktivitetet tjera të fokusuara në mirëqenien dhe shëndetin mendor të nxënësve. Disa nga rekomandimet e dhëna përgjatë këtij diskutimi në Edupod 4 për tu konsideruar me prioritet të lartë janë:

- Ndryshimi i udhëzimit administrativ të lëshuar në vitin 2013, në mbështetje të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, konkretisht nenit 37 paragrafi 1 dhe 2: Zgjedhja e nënpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukativo – arsimore parauniversitare. (MASHT, n.d.). Në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ, në përcaktimin e detyrave të punës dhe rolit të psikologut, më saktë pika 2.4 (MASHT, n.d.) kryerjen e detyrave të tjera të caktuara nga drejtori i institucionit, kjo krijon paqartësi dhe mundësi për adaptime të ndryshme e shpeshherë nuk përkojnë me rolin dhe përgjegjësitë e psikologut, gjë që rekomandohet të qartësohet duke përcaktuar qartë rolin, detyrat dhe përgjegjësitë.
- Krijimi i ambienteve gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe atraktive brenda shkollës është një tjetër rekomandim i dalë nga diskutimi. Një shkollë që të kontribuojë në të gjitha fushat e mirëqenies së fëmijëve/nxënësve, duhet vazhdimisht të forcojë kapacitetet e saja në ofrimin e një mjedisi të shëndetshëm për të mësuar, jetuar dhe punuar.
- Rekomandohet që në shërbimet e shëndetit mendor për fëmijë të përfshihet edhe shkolla si institucion dhe roli i saj në identifikimin, këshillimin, referimin dhe përcjelljen e fëmijëve/nxënësve me probleme mendore, kjo si rrjedhojë e diskutimit se nxënësit gjatë dhe pas marrjes së trajtimit profesional prapë kthehen dhe janë pjesë e shkollës, dhe roli i shkollës në ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor duhet të jetë integruar dhe jo përjashtues.
- Rekomandohet përfshirja e ekipeve multidisiplinare - ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, këshilltarë psikosocial, terapeutë të punës, logopedë, terapeutë zhvillimi apo profesionist të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor të fëmijëve.
- Rekomandohet që të ofrohen pako të instrumenteve të përshtatura me nevojat specifike të vendit (APA, n.d.), p.sh. ofrimi i instrumenteve të përshtatshme, cilësore dhe ofrimi i trajnimeve mbështetëse për profesionistë do të mundësonte përdorimin e tyre në mënyrë etike dhe të duhur.
- Rekomandohet që të ofrohen trajnime për mësimdhënësit me qëllim lehtësimin në identifikimin e shqetësimeve dhe problematikave të mundshme të fëmijëve/nxënësve. Ngritja e vetëdijës mbi rëndësinë dhe promovimin e rolit të psikologut në ofrimin e mbështetjes profesionale për fëmijët/nxënësit duhet të trajtohet me rëndësi të veçantë nga të gjitha palët që janë të përfshira në sistemin arsimor në vendin tonë.

## Referencat

- American Psychiatric Association. (2013). *Diagnostic and statistical manual of mental disorders (5th ed.)*
- American Psychological Association (APA). *Finding the right tools* <https://www.apa.org/gradpsych/2007/01/tools>
- Elias, M. J.-S. (1997). *Promoting social and emotional learning: Guidelines for educators*  
Alexandria, VA: Association for Supervision and Curriculum Development
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2015). *Ligji nr. 05/l-025 për shëndetin mendor*. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11229>
- Orhani, Z. (2014). *Psikologjia e emocioneve II Inteligjenca Emocionale*.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2013). *Udhëzim administrative nr.26.2013 zgjedhja e nënpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore parauniversitare*. <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10072>
- World Health Organization (WHO) (2021). *Making every school a health-promoting school Global standards and indicators*. <https://www.who.int/publications/i/item/9789240025059>
- World Health Organization (WHO). *Health-Promoting schools - Publications* [https://www.who.int/health-topics/health-promoting-schools#tab=tab\\_1](https://www.who.int/health-topics/health-promoting-schools#tab=tab_1)
- Zins, J. E. (2004). *Building academic success on social and emotional learning*. New York: Teachers College Press.





Funded by  
the European Union

